

VENDIM

Për Regjistrimin e Personit Juridik

Sot, më datë 15.7.2005, unë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Tiranë, A. Ce... pasi studiova kërkesën e paraqitur nga Z. Aleksander Frangaj, në cilësinë e administratorit të Shoqërisë "Media 66" Sh.p.k. (në formim e sipër), më poshtë referuar si Shoqëria,

KONSTATOVA:

Më datë 14.7.2005, Shoqëria "Media 66" Sh.p.k. me anë të administratorit të saj Z. Aleksander Frangaj ka bërë kërkesë për regjistrimin e saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Kjo Shoqëri vepron sipas legjislacionit shqiptar dhe ka këto të dhëna:

Emërtimi i Shoqërisë është "Media 66" Sh.p.k.

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë 10 (dhjete) vjet, duke filluar që prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe deri më 31.12.2015.

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në ADA Tower, Rr. Dervish Hima, Tiranë.

Objekti i Shoqërisë është aktiviteti radioteleviziv privat. Ai përfshin prodhimin, transmetimin, dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të cdo lloji me anë të zërit, figurave, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuara për publikun nëpërmjet valeve elektromagnetike, kabllave, perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjetër.

Aktiviteti i Shoqërisë do plotësohet duke respektuar paanshmerisht të drejtën për informacion, bindje politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, jetën private të njeriut, si dhe të drejtat dhe liritë themelore të tij.

Shoqëria mund të financohet nëpërmjet reklames dhe sponsorizimeve në përputhje me sa parashikon legjislacioni në fuqi.

Sipas legjislacionit në fuqi dhe për arritjen e objektit të Shoqërisë dhe qëllimeve të saj. Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet në mënyrë të drejtepërdrejte ose të terthorte që lidhen qëllimisht e mesipër të marre edhe interesa jo aksionere, në Shoqëri apo persona të tjerë juridik të cilët mund të kenë edhe qëllime të tjera por që lidhen me aktivitetin televiziv. Ajo mund të japë garanci dhe/ose mund të hipotekojë në favor të ndonjë banke, instituti krediti dhe financiar.

Aktiviteti i Shoqërisë do të zhvillohet në përputhje me aktet normative të Republikës së Shqipërisë dhe në mënyrë të vecantë me ligjin nr. 7638, të datës 19 nëntor 1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe ligjin nr.8410, datë 30 shtator 1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë".

Shoqëria do të realizojë, direkt apo indirekt, çdo lloj aktiviteti të lidhur me objektin e saj.

- Kapitali themeltar është 100.000 (njëqindmijë) lekë. Kapitali themeltar është i përbërë nga 100 (njëqind) pjesë kapitali të cilat kanë vlerën prej 1.000 (njëmijë) lekë secila, të gjitha të nënshkruara dhe të paguara. Kapitali i takon krejtësisht ortakut të vetëm Z. Aleksander Frangaj.

Administrator i shoqërisë është Z. Aleksander Frangaj, shtetas shqiptar, lindur në Lezhë, më 4.10.1968, me banim në Tiranë, Rruga Dervish Hima nr. 1, dhe me numër pasaporte Nr. 0011396

Kompetencat e administratorit përcaktohen në nenin 14 të Statutit të Shoqërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Meqënëse janë paraqitur të gjitha dokumentat e nevojshme dhe meqënëse unë i gjej ato të plotësuar në përputhje me Ligjin Nr. 7638, datë 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin Nr. 7632, datë 04.11.1992, "Për Pjesën e Parë të Kodit Tregtar",

VENDOSA:

Regjistrimin si "Media 66" sh.p.k.

Emri i Shoqërisë është "Media 66" Sh.p.k.

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë 10 (dhjetë) vjet, duke filluar që prej datës së regjistrimit të saj në Rregjistrin e Shoqërive Tregtare të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe deri më 31.12.2015.

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në ADA Tower, Rr. Dervish Hima, Tiranë.

Objekti i Shoqërisë është aktiviteti radioteleviziv privat. Ai përfshin prodhimin, transmetimin, dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të cdo lloji me anë të zërit, figurave, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuar për publikun nëpërmjet valeve elektromagnetike, kabllove, perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjetër.

Aktiviteti i Shoqërisë do të plotësohet duke respektuar paanshmerisht të drejtën për informacion, bindje politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, jetën private të njeriut, si dhe të drejtat dhe liritë themelore të tij.

Shoqëria mund të financohet nepermjet reklames dhe sponsorizimeve ne puthje me sa parashikon legjislacioni ne fuqi.

Sipas legjislacionit ne fuqi dhe per arritjen e objektit te Shoqërise dhe qellimeve te saj. Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet ne menyre te drejteperdrejte ose te terthorte që lidhen qellimin e mesiperm te marre edhe interesa jo aksionere, ne Shoqëri apo persona te tjere juridik te cilet mund te kene edhe qellime te tjera por që lidhen me aktivitetin televiziv. Ajo mund të jape garanci dhe/ose mund të hipotekojë ne favor te ndonje banke, insituti krediti dhe financiar.

Aktiviteti i Shoqërise do të zhvillohet ne perputhje me aktet normative te Republikës se Shqipërise dhe ne menyre te vecante me ligjin nr. 7638 , te dates 19 nentor 1992, "Per Shoqërite Tregetare" dhe ligjin nr.8410, date 30 shtator 1998 "Per radion dhe televizionin publik dhe privat ne Republikën e Shqipërise".


Shoqëria do të realizojë, direkt apo indirekt, çdo lloj aktiviteti te lidhur me objektin e saj.

- Kapitali themeltar është 100.000 (njëqindmijë) lekë. Kapitali themeltar është i përbërë nga 100 (njëqind) pjesë kapitali të cilat kanë vlerën prej 1.000 (njëmijë) lekë secila, të gjitha të nënshkruara dhe të paguara. Kapitali i takon krejtesisht ortakut te vetem Z. Aleksander Frangaj.

Administrator i shoqërisë është Z. Aleksander Frangaj, shtetas shqiptar, lindur në Lezhe, më 4.10.1968, me banim në Tirane, Rruga Dervish Hima nr. 1, dhe me numër pasaporte Nr. 0011396

Kompetencat e administratorit përcaktohen në nenin 14 të Statutit të Shoqërisë. Kundër këtij vendimi lejohet ankim.

U shpall në Tiranë sot, më datë __7.2005.

GJYQTARE
Arnie me Coco


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANË
Nr. i Vendimit 33812/11

VENDIM

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot, më datë 22 02.2006, unë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Tiranë, Blerina Muci, pasi studiova kërkesën e paraqitur nga Shoqëria "Media 66" sh.p.k. (më poshtë referuar "Shoqëria") përfaqësuar nga ortaku i vetem dhe administratori Aleksander Frangaj,

KONSTATOVA

Me Vendim Nr. 33812, datë 15.7.2005, marrë nga Gjykata e Rrethit Tiranë, është regjistruar në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate shoqëria Media 66 Sh.p.k.

Me date 25.7.2005, Ortaku i Vetem i shoqërisë ka marrë vendim për të ndryshuar kohezigjatjen e aktivitetit të shoqërisë nga 10 vjet në 25 vjet si dhe për të ndryshuar nenin 6 të statutit si më poshtë:

"Neni 5

Kohezigjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jete 25 vjet duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare të Gjykatës e Rrethit Tirane e deri në 31.12.2030."

Z. Frangaj ka paraqitur pranë kësaj gjykate kërkesën për depozitim të ndryshimeve në regjistrin tregtar dhe vendimin e ortakut të vetem të noterizuar prej noteres Luena Tolica në datë 8.2.2005,

PËR KËTO ARSYE:


Meqenëse janë paraqitur të gjitha dokumentat e nevojshme dhe meqenëse unë i gjej ato të plotësuar në përputhje me Ligjin Nr. 7638, datë 19 nëntor 1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin Nr. 7632, datë 4 nëntor 1992, "Për Pjesën e Parë të Kodit Tregtar",

VENDOSA:

- Pranimin e kërkesës;
- Depozitim të Ortakut të vetem të shoqërisë Media 66 sh.p.k. date 25.7.2005 për ndryshimin e kohezigjatjes së aktivitetit të shoqërisë;
- Të urdhëroj ndryshimet përkatëse në kolonën nr....., dhe nr. rendor të Regjistrin e Shoqërive Tregtare të kësaj Gjykate, duke u ndarë këto shënime me vizë të kuqe nga njëri-tjetri.

Tiranë, më datë 22.02.2006.

GJYQTARE
Blerina Mucaj



**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Media 66" SH.P.K.**

Sot, më datë 14.7.2005:

Z. Aleksander Frangaj, shtetas shqiptar, lindur në Lezhe, më 4.10.1968, me banim në Tirane, Rruga Dervish Hima nr. 1, dhe me numër pasaporte Nr. 0011396;

në përputhje me Ligjin Nr. 7638, datë 14.12.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" kemi vendosur të krijojmë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar "Media 66" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria"), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është "Media 66" Sh.p.k.

Neni 2

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në Rr. Dervish Hima, nr.1, ap. 10, Tirane

Neni 3

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë 10 vjet, duke filluar që prej datës së regjistrimit të saj në Rregjistrin e Shoqërive Tregtare të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Shoqëria mund të përfundojë apo vihet në likuidim përpara këtij afati ose mund të zgjasë aktivitetin e saj me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve.

Neni 4

- 4.1. Objekti i Shoqërisë është aktiviteti radioteleviziv privat. Ai përfshin prodhimin, transmetimin, dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të cdo lloji me ane të zërit, figures, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuara për publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kablllove, perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjetër.
- 4.2 Aktiviteti i Shoqërisë do plotësohet duke respektuar paanshmerisht të drejtën për informacion, bindje politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, jetën private të njeriut, si dhe të drejtat dhe liritë themelore të tij.
- 4.3 Shoqëria mund të financohet nepermjet reklames dhe sponsorizimeve në përputhje me sa parashikon legjislacioni në fuqi.
- 4.4 Sipas legjislacionit në fuqi dhe për arritjen e objektivit të Shoqërisë dhe qëllimeve të saj. Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të terthortë që lidhen qëllimin e mesipër të marre edhe

interesa jo aksionere, ne Shoqei apo persona te tjere juridik te cilet mund te kene edhe qellime te tjera por qe lidhen me aktivitetin televiziv. Ajo mund te jape garanci dhe/ose mund te hipotekojë ne favor te ndonje banke, instituti krediti dhe financiar.

4.5 Aktiviteti i Shoqerise do te zhvillohet ne perputhje me aktet normative te Republikës se Shqiperise dhe ne menyre te vecante me ligjin nr. 7638 , te dates 19 nentor 1992, "Per Shoqerite Tregetare" dhe ligjin nr.8410, date 30 shtator 1998 "Per radion dhe televizionin publik dhe privat ne Republikën e Shqiperise".

4.6 Shoqëria do të realizojë, direkt apo indirekt, çdo lloj aktiviteti te lidhur me objektin e saj.

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kapitali themeltar është i përbërë nga 100 (njëqind) pjesë kapitali, të gjitha të nënshkruara dhe të paguara, me vlerën prej 1,000 (njëmijë) lekë secila.

Neni 6

Derdhja e kapitalit themeltar është bërë krejtësisht nga ortaku i vetem Z., Aleksander Frangaj.

Neni 7

Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurave të parashikuara nga Neni i Statutit.

Neni 8

Shoqëria administrohet nga 1 (nje) Administrator, qoftë edhe jo ortak, i cili do të emërohet apo shkarkohet nga Asambleja e Zakonshme.
Administratori emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve për një periudhë e cila do te percaktohet ne aktin e emerimit, ne te kundert administratori dot e qendroje ne detyre per afat te pacaktuar.

Nëpërmjet këtij akti, emërohet Administrator:

Z. Aleksander Frangaj, shtetas shqiptar, lindur në Lezhe, më 4.10.1968, me banim në Tirane, Rruga Dervish Hima nr. 1, dhe me numër pasaporte Nr. 0011396;

Administratori ka të drejtë të vepronë, personalisht ose duke i deleguar personave të tretë, lidhur me të gjitha procedurat për regjistrimin e Shoqërisë si person juridik pranë organit kompetent. Ai është i autorizuar të vepronë për llogari të Shoqërisë deri sa regjistrimi i saj pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë të ketë përfunduar.



Administratorit të sipërpërmendur i jepen të gjitha të drejtat e administrimit, të zakonshëm e të jashtëzakonshëm, duke përfshirë edhe nënshkrimin dhe ekzekutimin e të gjitha akteve në emër dhe për llogari të dhe ata mund të delegojnë pushtetin e tyre tek persona të tretë me prokura të posaçme të noterizuara.

Neni 9

Çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet ortakëve në lidhje me këtë marrëveshje apo Shoqërinë (përveç atyre personale apo që nuk kanë të bëjnë me Shoqërinë), do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.


Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ajo do t'i besohet Gjykatës së Rrethit Tiranë, përveç kur një nga ortakët vendos të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes nga një trup arbitrash sipas procedurës së përcaktuar në Statut.

Lexuar, nënshkruar


Tiranë, më 14.7.2005.

Z. Aleksander Frangaj

Aleksander Frangaj



STATUT I "MEDIA 66" SH.P.K.



Sot, më date 14.7.2005, i poshtëshënuari:

- Z. Aleksander Frangaj, shtetas shqiptar, lindur në Lezhe, më 4.10.1968, me banim në Tiranë, Rruga Dervish Hima nr. 1, dhe me numër pasaporte Nr. 0011396;

Ka vendosur të nënshkruajë Statutin e mëposhtëm për themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Media 66" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

Kapitulli I EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1 - Forma

- 1.1. Shoqëria krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe aktiviteti i saj rregullohet me anë të këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit.
- 1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Neni 2 - Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është "Media 66" Sh.p.k.

Neni 3 - Objekti

- 3.1. Objekti i Shoqërisë është aktiviteti radioteleviziv privat. Ai përfshin prodhimin, transmetimin, dhe ritransmetimin e programeve radiotelevizive dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, figurave, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuara për publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kablove, perseritesve, sateliteve apo me çdo mjet tjetër.
- 3.2. Aktiviteti i Shoqërisë do plotësohet duke respektuar paanshmerisht të drejtën për informacion, bindje politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, jetën private të njeriut, si dhe të drejtat dhe liritë themelore të tij.
- 3.3. Shoqëria mund të financohet nepermjet reklames dhe sponsorizimeve në përputhje me sa parashikon legjislacioni në fuqi.



- 3.4 Sipas legjislacionit ne fuqi dhe per arritjen e objektit te Shoqerise dhe qellimeve te saj. Shoqeria mund te kryeje te gjitha veprimet ne menyre te drejteperdrejte ose te terthorte qe lidhen qellimin e mesiperm te marre edhe interesa jo aksionere, ne Shoqeri apo persona te tjere juridik te cilet mund te kene edhe qellime te tjera por qe lidhen me aktivitetin televiziv. Ajo mund te jape garanci dhe/ose mund te hipotekojë ne favor te ndonje banke, insituti krediti dhe financiar.
- 3.5 Aktiviteti i Shoqerise do te zhvillohet ne perputhje me aktet normative te Republikes se Shqiperise dhe ne menyre te vecante me ligjin nr. 7638 , te dates 19 nentor 1992, "Per Shoqerite Tregtare" dhe ligjin nr.8410, date 30 shtator 1998 "Per radion dhe televizionin publik dhe privat ne Republikën e Shqiperise".
- 3.6. Shoqëria do të realizojë, direkt apo indirekt, çdo lloj aktiviteti te lidhur me objektin e saj.

Neni 4 - Selia

- 4.1. Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në Rr. Dervish Hima, nr.1, ap. 10, Tirane.
- 4.2. Mbledhja e Jashtëzakonshme e Ortakëve mund të vendosë të transferojë selinë e Shoqërisë në një vend tjetër, apo mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë kudo brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 5 - Kohëzgjatja

- 5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë 10 vjet, duke filluar që prej datës së regjistrimit të saj në Rregjistrin e Shoqërive Tregtare të Gjykatës së Rrethit Tiranë.
- 5.1 Shoqëria mund të përfundojë apo vihet në likuidim përpara këtij afati ose mund të zgjasë aktivitetin e saj me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve.

Neni 6 - Përgjegjësitë

- 6.1. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qëllime që nuk përputhen me ato të përcaktuara nga Statuti dhe Akti i Themelimit.
- 6.2. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortakët në emrin e tyre personal ndaj personave të tretë.

2

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR

Neni 7 - Kapitali themeltar

- 7.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë.
- 7.2. Kapitali themeltar është i përbërë nga 100 (njëqind) pjesë kapitali të gjitha të nënshkruara dhe të paguara, me vlerën prej 1,000 (njëmijë) lekë secila.

Neni 8 - Kontributet dhe pjesët e kapitalit

- 8.1. Derdhja e kapitalit themeltar është bërë krejtësisht nga ortaku i vetem Z, Aleksander Frangaj i cili ka derdhur shumen prej 100,000 leke me anë të depozitimit të saj pranë noteres Mimoza Sadushi, siç vërtetohet prej certifikatës datë7.2005
- 8.2. Sipas kontributit të cituar me sipër:
 - Z. Aleksander Frangaj i takojnë 100 (njëqind) pjesë kapitali, të barabarta me 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar.

Neni 9 - Rritja e kapitalit themeltar

Asambleja e Jashtëzakonshme e Ortakëve mund të rrisë pa kufi kapitalin e Shoqërisë.

Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me pjesët e kapitalit të zotëruara. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me pjesëmarrjen respektive si dhe në rast të mungesës së nënshkrimit, mund të nënshkruhen nga të tretët.

Neni 10 - Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 10.1. Shoqëria mund të reduktojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme, me votën pro të ortakëve që zotërojnë të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e kapitalit themeltar. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të reduktohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 10.2. Zvogëlimi i kapitalit përballohet prej secilit prej ortakëve në mënyrë proporcionale me pjesët e kapitalit të zotëruara.

Neni 11 - Transferimi i pjesëve të kapitalit dhe e drejta e parablerjes

11.1. Pjesët e kapitalit mund t'u transferohen të tretëve tërësisht ose pjesërisht, vetëm me vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve.

11.2. Transferimi për çfarëdo arsyeje, tërësisht ose pjesërisht i pjesëve të kapitalit të Shoqërisë është subjekt i të drejtës së parablerjes në favor të ortakëve të tjerë, të cilët mund të ushtrojnë këtë të drejtë në raport me pjesët e tyre të kapitalit, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit të dërguar me letër rekomande, i cili përmban ofertën. Në rast se ortakët e tjerë nuk përgjigjen brenda afatit të parashikuar, konsiderohet se kanë hequr dorë prej të drejtës së parablerjes.

11.3. Në rast se njëri prej ortakëve refuzon apo heq dorë nga ushtrimi i të drejtës së tij të parablerjes, ortakët e tjerë, të cilët tashmë kanë ushtruar të drejtën e tyre të parablerjes, mund ta ripërdorin këtë të drejtë edhe për pjesën e ofruar ortakut që e refuzoi atë.

11.4. Në rast se më shumë se një ortak dëshirojnë të ripërdorin të drejtën e parablerjes, pjesët e kapitalit të ofruara ortakut që nuk dëshiron ta ushtronte të drejtën e tij, ndahen në proporcion me pjesët e kapitalit respektiv.

11.5. Në rast se vetëm njëri prej ortakëve dëshiron ta ushtrojë të drejtën e parablerjes, pjesa e kapitalit të ofruar i transferohet atij tërësisht ose në atë masë që ky ortak dëshiron.

11.6. Për këtë qëllim, ortakët që dëshirojnë të ripërdorin të drejtën e tyre të parablerjes duhet t'i njoftojnë vendimin e tyre ortakut që dëshiron të transferojë pjesët e tij të kapitalit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh që prej marrjes së lajmit për mos ushtrimin e së drejtës së parablerjes prej ndonjërit prej ortakëve.

11.7. Të gjitha njoftimet e sipërpërmendura do të bëhen me shkrim dhe i adresohen Administratorit të Shoqërisë.

KAPITULLI III ASAMBLEJA E ORTAKËVE, ADMINISTRATORI, KONTROLI

Neni 12 -Të drejtat e pjesëmarrjes dhe votimit

12.1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e vet dhe të japë aq vota sa pjesë të kapitali themeltar zotëron.

12.2. Çdo ortak ka të drejtë të caktojë me një prokurë të shkruar një përfaqësues, në Asamble.

- 12.3. Ortaku nuk mund të delegojë të drejtën për të votuar për një pjesë të kapitalit të tij, nëse voton personalisht për tjetrën.

Neni 13 - Thirrja e Asamblesë së Ortakëve

- 13.1. Asambleja e Zakonshme e Ortakëve thirret një herë në vit brenda 6 (gjashtë) muajsh nga mbyllja e vitit për miratimin e bilancit, të relacioneve të Administratorit dhe të ekspertit kontabël (nëse është emëruar), veç inventarit.
- 13.2. Asambleja duhet të thirret nga Administratori nëpërmjet njoftimit me letër rekomande apo faks, që duhet t'u dërgohet ortakëve në adresat e dhëna Shoqërisë, dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet për t'u trajtuar dhe për t'u vendosur, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 13.3. Asambleja do të quhet e thirrur rregullisht, edhe pa respektuar këto formalitete, nëse marrin pjesë apo janë të përfaqësuar të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre, Administratori dhe eksperti kontabël (nëse është emëruar).
- 13.4. Asambleja e Zakonshme e Ortakëve vendos mbi të gjitha çështjet që nuk vendosen nga Asambleja e Jashtëzakonshme dhe në veçanti për sa vijon:
- emërimin apo zëvendësimin e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar);
 - miratimin e planeve të prodhimit, organizimit, zhvillimit të aktivitetit, buxhetit, llogarive vjetore, relacioneve të administratorit dhe ekspertëve kontabël të autorizuar, dhe inventarin;
 - shpërndarjen e fitimeve.
- 13.5. Asambleja e Zakonshme quhet e mbledhur rregullisht dhe mund të marrë vendime nëse janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit.
- 13.6. Nëse mungon quorumi i pjesëmarrësve, Asambleja duhet të thirret për herë të dytë, dhe mund të vendosë me shumicë të thjeshtë pavarësisht nga numri i ortakëve të pranishëm ose të përfaqësuar dhe votues, me përjashtim të rastit të emërimit apo shkarkimit të administratorit. Në këtë rast, ortakët e pranishëm dhe votat e shprehura nga ortakët votues ose të përfaqësuar duhet të jenë 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar edhe në rast të një thirrje të dytë.
- 13.7. Asambleja e Jashtëzakonshme quhet e mbledhur rregullisht dhe mund të marrë vendime në mbledhjen e parë dhe të dytë, me votimin e

ortakëve që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e kapitalit nëse ortakët të cilët përfaqësojnë $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e kapitalit themeltar marrin pjesë.

13.8. Asambleja e Jashtëzakonshme, vendos mbi:

- ndryshimet e aktit të themelimit dhe të statutit;
- formimin e filialeve, degëve dhe përfaqësive jashtë shtetit;
- rritjen apo rrvogëlimin e kapitalit themeltar;
- ndryshimet në objekt dhe mbi blerjen e pjesëve të kapitalit në shoqëri të tjera;
- transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar;
- emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve.

13.9. Asambleja cakton një kryetar për secilën mbledhje nga ortakët apo person i tretë.

13.10. Vendimet e Asamblesë duhet të shkruhen në procesverbal, i cili nënshkruhet nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari. Në procesverbal duhet të përfshihen të përmbledhura, me kërkesën e ortakëve, edhe deklaratat e tyre.

Neni 14 - Administrimi

14.1. Shoqëria administrohet nga 1 (nje) Administrator, qoftë edhe jo ortak, i cili do të emërohet apo shkarkohet nga Asambleja e Zakonshme. Administratori emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve për një kohëzgjatje që parashikohet në aktin e emerimit, në të kundërt do të qendrojnë në detyrë për një afat të pacaktuar, deri në largimin e tyre me vendim të asamblese.

14.2. Administratori përfaqëson Shoqërinë tek të tretët dhe ka të gjitha kompetencat, të zakonshme dhe të jashtëzakonshme me qëllim që të arrijë objektin e Shoqërisë.

Neni 15 - Eksperti kontabël i Autorizuar

15.1. Nëse është e nevojshme ose kërkohet nga ligji, kontrolli i bilancit financiar dhe i librave të kontabilitetit të Shoqërisë do t'i besohet një ekspertit kontabël, i emëruar për një periudhë 3 (tre) vjeçare me mundësinë për tu rizgjedhur për një periudhë tjetër nga Asambleja e Zakonshme.

15.2. Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet me të njëjtën procedurë.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 16.1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 16.2. Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 16.3. Bilancet vjetore, inventari, relacionet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga Asambleja me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë më tepër se 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar.
- 16.4. Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 17 - Fitimet


- 17.1. Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% (pesë përqind) që caktohen për rezervën ligjore deri në 10% (dhjetë përqind) e kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu të gjitha shumat që Asambleja vendos t'i vërë mënjanë, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 17.2. Asambleja mund të vendosë edhe zbritje speciale në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, në shërbimet e mëposhtme.

KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Neni 18 - Shpërndarja

- 18.1. Shoqëria shpërndahet me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Jashtëzakonshme të ortakëve.
- 18.2. Shoqëria nuk shpërndahet në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, pazotësisë juridike, vdekjes, ose falimentimit të Ortakëve.

Neni 19 - Likuidimi



7

19.1. Në rast shpërndarje, Shoqëria duhet të likuidohet.

19.2. Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin relacionet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.

19.3. Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë, me shumicën e ortakëve që nevojitet për Mbledhjet e Jashtëzakonshme, mbi miratimin e bilancit financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

19.4. Pas pagesës së kreditorëve dhe mbledhjes së kredive të jashtëzakonshme, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 20 - Transformimi i shoqërisë

Shoqëria mund të shndërrohet në shoqëri kolektive ose në shoqëri kolektive vetëm me miratimin unanim të ortakëve, ndërsa mund të shndërrohet në shoqëri aksionere me miratimin e shumicës së ortakëve që mbajnë më shumë se $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e pjesëve të kapitalit themeltar.


Neni 21 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve


21.1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje, si edhe ato që mund të lindin midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

21.2. Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ajo do t'i besohet vetëm Gjykatës së Rrethit Tiranë,

Lexuar dhe nënshkruar

Tiranë, më 14/7/2005


Z. Aleksander Frangaj



KËRKESË

H. E. Balla
M. D. 2006
11 MAJ 2006
[Signature]

33812/2

**GJYKATËS SË RRETHIT
GJYQËSOR TIRANË
SEKSIONIT TREGTAR**

KËRKUESI: Shoqëria Media 66 sh.p.k., person juridik i regjistruar me vendimin nr. 33812, me date 15.7.2005, e përfaqësuar nga ortaku i vetem dhe administratori Aleksander Frangaj;

OBJEKTI: Depozitimi ne Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate, të vendimit te ortakut te vetem date

BAZA LIGJORE: Ligji Nr. 7632, datë 04.11.1992, "Për Pjesën e Parë të Kodit Tregtar" dhe Ligji Nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhën Respektuar nga Shoqëritë Tregtare".

Shoqeria Media 66 sh.p.k. është nje shoqeri dhe përgjegjesi te kufizuar e regjistruar me vendim nr. 33812, me date 15.7.2005.

Me date *11.5.2006*, ortakut i vetem ka vendosur të shtojë objektin e veprimtarisë së shoqërisë duke shtuar dhe aktivitetet e mëposhtme në statutin e shoqërisë:

"Neni 3"
Botimi i gazetave, revistave, dhe periudikeve të tjerë ndryshëm si dhe të gjitha aktivitetet e nevojshme për realizimin e botimit, publikimit e shpërndarjes së tyre.

Bar restorant.

Duke qendur se shtimi i i përmes objektit të veprimtarisë në statut perben nje nga elementet qe duhet te regjistrohen ne regjistrin tregtar te gjykates e Shkalles se Pare Tirane, ne baze te Nenit 19 te Ligjit Nr. 7632, date 4.11.1992, "Per Pjesen e Pare te Kodit Tregtar dhe neni 33 i Ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet qe Duhën Respektuar nga Shoqëritë Tregtare", i kërkojmë Gjykatës së Rrethit Tiranë të depozitoje në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate vendimin e ortakut të vetem.


MEDIA 66 SH.P.K.
Aleksander Frangaj
Ortak i vetem dhe administrator

Av. Erinda F. Ballanca

Erinda F. Ballanca

12

[Handwritten notes and signatures in the left margin, including "Bar restorant", "atlet", "33812/2", and "11.5.2006"]



33812/1

KËRKESE

H. B. Anca
10.07.2006
10SHKURT 2006

**GJYKATËS SË RRETHIT TIRANË
SEKSIONIT TREGTAR**

KËRKUESI:

Shoqëria Media 66 sh.p.k., person juridik i regjistruar me vendimin nr. 33812, me date 15.7.2005, e përfaqësuar nga ortaku i vetem dhe administratori Aleksander Frangaj;

OBJEKTI:

Depozitimi ne Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate, të vendimit te asamblese se ortakeve

BAZA LIGJORE:

Ligji Nr. 7632, datë 04.11.1992, "Për Pjesën e Parë të Kodit Tregtar" dhe Ligji Nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhën Respektuar nga Shoqëritë Tregtare".

Si depozitimet
dt 22.02.06

Shoqëria Media 66 sh.p.k. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar me vendim nr. 33812, me date 15.7.2005.


Me date *8/2.2006* ortaku i vetem ka vendosur ndryshimin e kohezgjatjes së shoqërisë nga 10 vjet në 25 vjet duke ndryshuar edhe dipoziten përkatëse të statutit të shoqërisë si me poshte:

"Neni 5

Kohezgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë 25 vjet duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare të Gjykatës së Rrethit Tirane e deri në 31.12.2030."

Vendim i Oltos Kurt
Vetëm dt 15.7.05

Duke qenë se ndryshimi i mesipër i statutit përben një nga elementet që duhet të regjistrohen në regjistrin tregtar të gjykatës së Shkalles së Parë Tirane, në bazë të Nenit 19 të Ligjit Nr. 77632, datë 4.11.1992, "Për Pjesën e Parë të Kodit Tregtar dhe neni 33 i Ligjit Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhën Respektuar nga Shoqëritë Tregtare", i kërkojmë Gjykatës së Rrethit Tirane të depozitojë në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate vendimin e ortakut të vetem.


MEDIA 66 SH.P.K.
Aleksander Frangaj
Ortak i vetem dhe administrator

J. A. Caco
15.07.2005

33 812

15 KOPJA



KËRKESË

GJYKATËS SË RRETHIT TIRANË
SEKSIONIT TREGTAR

KËRKUESI:

Shoqëria Media 66 sh.p.k. në formim e sipër (më poshtë referuar si "Shoqëria") e përfaqësuar nga Z. Aleksander Frangaj në cilësinë e administratorit

OBJEKTI:

Regjistrimi në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate, të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Media 66" Sh.p.k.

baza LIGJORE:

Ligji Nr. 7632, datë 04.11.1997, "Për Pjesën e Parë të Kodit Tregtar" dhe Ligji Nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhet Respektuar nga Shoqëritë Tregtare".

më datë __.07.2005, unë i nënshkruari, Aleksander Frangaj, duke u mbështetur Nenin 8 të Ligjit Nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhet Respektuar nga Shoqëritë Tregtare" i kërkojmë Gjykatës së Rrethit Tiranë të regjistrojë në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate këtë Shoqëria.

ari i Shoqërisë është "Media 66" Sh.p.k.

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë 10 (dhjetë) vjet, duke filluar që prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe deri më 31.12.2015.

Shoqëria zyrtare e Shoqërisë ndodhet në ADA Tower, Rr. Dervish Hima, nr. 11 Tiranë.

Objekti i Shoqërisë është aktiviteti radioteleviziv privat. Ai përfshin prodhimin, transmetimin, dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të cdo lloji me zërin, figurat, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuar për publikun përmjet valeve elektromagnetike, kablove, përsëritësve, sateliteve apo me cdo mënyrë tjetër.

Aktiviteti i Shoqërisë do plotësohet duke respektuar paanshmerisht të drejtën për informacion, bindje politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, jetën private dhe familjare, si dhe të drejtat dhe liritë themelore të tij.

Shoqëria mund të financohet nëpërmjet reklames dhe sponsorizimeve në përputhje me parashikimet e ligjshme dhe të rregulluara nga legjislacioni në fuqi.

Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të ndërmjetshme që lidhen qëllimisht me marrjen e interesave jo aksionerë, në përputhje me ligjin apo persona të tjerë juridikë të cilët mund të kenë edhe qëllime të tjera por që

lidhen me aktivitetin televiziv. Ajo mund te jape garanci dhe/ose mund te hipotekoje ne favor te ndonje banke, insituti krediti dhe financiar.

Aktiviteti i Shoqerise do te zhvillohet ne perputhje me aktet normative te Republikes se Shqiperise dhe ne menyre te vecante me ligjin nr. 7638 , te dates 19 nentor 1992, "Per Shoqerite Tregtare" dhe ligjin nr.8410, date 30 shtator 1998 "Per radion dhe televizionin publik dhe privat ne Republiken e Shqiperise".


Shoqëria do të realizojë, direkt apo indirekt, çdo lloj aktiviteti te lidhur me objektin e saj.

- Kapitali themeltar është 100.000 (njëqindmijë) lekë. Kapitali themeltar është i përbërë nga 100 (njëqind) pjesë kapitali të cilat kanë vlerën prej 1.000 (njëmijë) lekë secila, të gjitha të nënshkruara dhe të paguara. Kapitali i takon krejtësisht ortakut te vetem Z. Aleksander Frangaj.

Administrator i shoqërisë është Z. Aleksander Frangaj, shtetas shqiptar, lindur në Lezhe, më 4.10.1968, me banim në Tirane, Rruga Dervish Hima nr. 1, dhe me numër pasaporte Nr. 0011396

Kompetencat e administratorit përcaktohen në nenin 14 të Statutit të Shoqërisë.

MEDIA 66 SH.P.K. (në formim e sipër)
Aleksander Frangaj, Administratori



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 4422..... Rep.

Nr. Kol.

VËRTETIM

Sot më datë 14.07.2005, në Zyrën e Noterisë, përpara meje Noteres, *A. Soelja* me zyrë noterie në Rr. e Durrësit, u paraqit personalisht Z. Aleksander Frangaj, shtetas shqiptar, lindur në Lezhe, më 4.10.1968, me banim në Tirane, Rruga Dervish Hima nr. 1, dhe me numër pasaporte Nr. 0011396 me zotësi të plotë për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova pasi verifikova dokumentin përkatës të identifikimit, në cilësinë e administratorit të Shoqërisë "Media 66" sh.p.k. (në formim e sipër), i cili nënshkroi lirisht përpara meje këtë Kërkesë për regjistrimin e Shoqërisë "Media 66" pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë, dhe unë Noterja e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTERE

A. Soelja

Soelja




REPubLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR.....02.....REP
NR.....KOL.

VERTETIM

Sot me date 14.07.2005 (dymije e pese), para meje Mimoza Sadushaj, notere ne qytetin Tirane, me zyre ne Rr. " Vaso Pasha ", Pall. 13/1, u paraqit personalisht Z.ALEKSANDER FRANGAJ administrator I shoqerise " MEDIA 66" sh.p.k, banues ne Tirane, me identitet te njohur prej meje, i cili depozitoi perpara meje shumen prej 100.000 leke (njeqind mije leke) si kapital per krijimin e shoqerise " Media 66" sh.p.k

NOTERE

MIMOZA SADUSHAJ




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NR. 4420 REP.
NR. 1223 KOL.

VËRTETIM

Sot më date 14.7.2005, në Zyrën e Noterisë, përpara meje Noteres, Mimoza Sadushi, u paraqitën personalisht Z. Aleksander Frangaj, shtetas shqiptar, lindur më 4.10.1968, në Lezhe, banues në Tiranë, Rruga Dervish Hima, nr. 1, ap. 10/1 pas.nr. 0011396, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, përkatësisht në cilësinë e ortakut të vetëm të Shoqërisë "Media 66" Sh.p.k. (në formim e sipër), i njohur personalisht prej meje nënshkroi lirisht përpara meje Aktin e Themelimit të Shoqërisë "Media 66", dhe unë Noterja e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTERE

Mimoza Sadushi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

NR. 4421 REP.


NR. 1224 KOL.

VËRTETIM

Sot më date 14.7.2005, në Zyrën e Noterisë, përpara meje Noteres, Mimoza Sadushi, u paraqitën personalisht Z. Aleksander Frangaj, shtetas shqiptar, lindur më 4.10.1968, në Lezhe, banues në Tiranë, Rruga Dervish Hima, nr. 1, ap. 10/1 pas.nr. 0011396, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, përkatësisht në cilësinë e ortakut te vetem të Shoqërisë "Media 66" Sh.p.k. (në formim e sipër), i njohur personalisht prej meje nënshkroi lirisht përpara meje Statutin e Shoqërisë "Media 66", dhe unë Noterja e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTERE

Mimoza Sadushi



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 91 Rep.

Nr. 28 Kol.

VERTETIM

Sot me daten 08 Shkurt 2006 (dymije e gjashte) u paraqit personalisht para meje noteres ALEKSANDER FRANGAJ , per identitetin e te cilit une noterja u sigurova nga pasaporta e tij personale ,I cili me deklaroi se sa me siper eshte nje kerkese e bere jashte kesaj zyre me vullnetin e lire dhe te plote te tij e pasi u lexua u nenshkrua rregullisht prej tij perpara meje noteres, ndersa une noterja duke e gjetur kete kerkese konforme ligjit e vertetoj ate.


NOTERE

LUENA TOLICA
DHOMA E NOTEREVE
068 20 70 787



MEDIA 66 Shpk

Ada Tower
Ruga Dervish Hima Nr. 1
Tirana - Albania



Vendim i Ortakut te Vetem te Shoqerise

MEDIA 66 SH.P.K.

Sot me date 25/ 7/2005, Aleksander Frangaj ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise Media 66 sh.p.k., person juridik shqiptar i regjistruar ne regjistrin tregtar me vendim nr. 33812, me date 15.7.2005, ka marre vendimin e meposhtem:

Ndryshimin e kohezgjatjes se aktivitetit te shoqerise Media 66 sh.p.k. nga 10 vjet ne 25 vjet.

Si rrjedhoje ketij ndryshimi, vendosa te ndryshoj edhe nenin 5 te Statutit te Shoqerise Media 66 si me poshte vijon:

“Neni 5

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise do te jete 25 vjet duke fillaur nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare te Gjykates e Rrethit Tirane e deri ne 31.12.2030.”

Ngarkoj Av. Erinda Ballanca te ndjeke te gjitha procedurat ligjore per depozitimin e vendimit te mesiperme prane regjistrin tregtar sipas ligjit, duke perfshire nder te tjera edhe nenshkrimin e kerkeses drejtuar gjykates.

Ortaku i vetem
Aleksander Frangaj

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 92 Rep.

Nr. 29 Kol.

VERTETIM

Sot me daten 08 Shkurt 2006 (dymije e gjashte) u paraqit personalisht para meje noteres ALEKSANDER FRANGAJ , per identitetin e te cilit une noterja u sigurova nga pasaporta e tij personale ,I cili me deklaroi se sa me siper eshte nje Vendim I Ortakut te vetem te shoqerise Media 66 Shpk e bere jashte kesaj zyre me vullnetin e lire dhe te plote te tij dhe u nenshkrua rregullisht prej tij perpara meje noteres, ndersa une noterja duke e gjetur kete kerkese konforme ligjit e vertetoi ate.

NOTERE

LUENA TOLICA
DHOMA E NOTEREVE
068 29 78 787




[Handwritten signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. Rep. 744
Nr. Kol. 214

VËRTETIM

Sot, më datë 05/05/2006, në Zyrën e Noterisë, përpara meje Noteres, Meri Cala, u paraqit personalisht Av. Erinda Ballanca, qytetar shqiptar, lindur më 29.10.1974, banues në Tiranë, Shqipëri, në cilësinë e përfaqësueses ligjore të ortakut të vetëm të shoqërisë Media 66 Sh.p.k. Z. Aleksandër Frangaj, i cili e ngarkon të ndjek të gjitha procedurat ligjore për depozitimin e vendimit të ortakut të vetëm dt. 05/05/2006. Av. Erinda Ballanca ka zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u sigurova pasi verifikova dokumentat përkatës të identifikimit, e cila më deklaroi se ka hartuar këtë kërkesë jashtë zyrës së noterit me vullnetin e saj të lirë, kërkesë të cilën e nënshkroi përpara meje noteres dhe unë e vërtetoj ato sipas ligjit.



NOTERE

(Meri Cala)
Pall

VENDIM I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE

MEDIA 66 SH.P.K.

Sot me date 05/05/2006, Aleksander Frangaj, i biri i Gjyestes dhe i Vasilit, i datelindjes 4.10.1968, ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise Media 66 sh.p.k., person juridik shqiptar i regjistruar ne regjistrin tregtar me vendim nr. 33812, me date 15.7.2005, ka marre vendimin e meposhtem:

te shtoje objektin e veprimtarise se shoqerise duke shtuar edhe aktivitetet e meposhtme:

Botimi i gazetave, revistave, dhe periodikeve te tjere te ndryshem si dhe te gjitha aktivitet e nevojshme per realizmin e botimit, publikimit e shitjes se tyre


Bar, restorant.

Ndryshimin e nenit 3 te statutit te shoqerise duke perfshire ne objektin e saj edhe aktivitetin e percaktuar me siper.

Te ngarkoj Av. Erinda Ballanca te ndjeke te gjitha procedurat ligjore per depozitimimin e vendimit te mesiperme prane regjistrin tregtar sipas ligjit, duke perfshire nder te tjera edhe nenshkrimin e kerkeses drejtuar gjykates.

Ortaku i vetem
Aleksander Frangaj

Aleksander Frangaj



Frangaj

Tiranë 5-06 2006

Nr. 2798 Prot.

Nr. 6176 Mandati

LEJE HIGJENO - SANITARE Nr. 2050

Në zbatim të Ligjit Nr. 7643, datë 02.12.1992 "Për Inspektoriatin Sanitar Shtetëror".
neni 12, dhe Rregulloreve përkatëse higjieno - sanitare, mbështetur në kërkesën e
bërë nga: ALEKSANDER FKNGAJ MEDIA 66 SH.PK.
për objektin: BAR RESTAURANT, me adresë
(vend ndodhje të saktë) Rr. ALEKSANDER MOJSIU
dhe vlerësimin e kontrollit higjieno - sanitar paraprak të bërë nga Inspektori Sanitar
Shtetëror NAJIM KAMA, me datë 3-06-2006

VENDOSA:

Dhënie Leje higjieno - sanitare për:

- a. Sheshin e ndërtimit të Objektivit _____
- b. Projektin ndërtimor të objektit _____
- c. Rikonstruksionit të objektit _____
- d. Vënien në shfrytëzim të objektit BAR RESTAURANT
(të shënohet vetëm në rubrikën e kërkuar)

Leja higjieno - sanitare nuk lejohet të përdoret për destinacion tjetër. Çdondryshim
që bëhet në projekt/objekt do të ripërsëritet Leja.
Kjo Leje është e vlefshme për një vit nga data e dhënies së saj. Zotëruesi i saj në
mbarim të këtij afati është i detyruar të rifreskojë Lejen në organet e Inspektoriatit
Sanitar Shtetëror.

KRYEINSPEKTORI SANITAR SHTETËROR I RRËTIT


Dr. MANESH HANASI

Inspektori Sanitar Shtetëror

NAJIM KAMA



*Kopje re Ar. Supt
Bev treg. 45.
25.01.2007*



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
PROKURORIA
E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË**

395
25/1/2007

V E N D I M

PËR MARRJEN E DOKUMENTAVE

Në Tiranë, më 22.01.2007
Unë Olsian Çela, prokuror, pasi studiova aktet e procedimit penal nr.4372 te vitit
2006

K O N S T A T O V A

Se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr.4372 për veprat penale të “korrupsionit aktiv” dhe “korrupsionit pasiv” të parashikuara nga nenet 244 dhe 259 të Kodit Penal, veprat penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv të gjyqtarit të parashikuara nga nenet 319 dhe 319/a të Kodit Penal, “dhënia e një vendimi të padrejtë” e parashikuar nga neni 315 i Kodit Penal, “shpërdorimi i detyrës” i parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Për nevoja të hetimit, është e nevojshme të merret në regjistrin tregtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë një kopje e të gjithë dokumentacionit që lidhet me regjistrimin e shoqërisë Media 66.

Për këto arsye, në mbështetje të nenit 191 të Kodit të Procedurës Penale

V E N D O S A


1-marrjen e kopjeve të dokumentave të cituara më sipër në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nga oficerët e policisë gjyqësore Kledian Llaho dhe Ervin Brahaj të cilët të mbajnë edhe procesverbalin përkatës.

2-kopjet e dokumentave të njësohen me vulën e organit që i disponon.

3-kopja e vendimit t’u komunikohet të interesuarve.

PROKURORI

OLSIAN ÇELA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Prokuroria e Rrethit Gjyqësor
TIRANE

PROCESVERBAL

Për marrjen e dokumentave

Në Tiranë, viti 2007, muaji Janar, datë 25.

Unë Ervin Brahaj, Oficer i Policisë Gjyqësore, në zbatim të vendimit të datës 22.01.2007 të Prokurorit Olsian Çela, dhe bazuar në nenin 191 të K.Pr.Penale mbaj këtë procesverbal për të dokumentuar marrjen e një kopje të gjithë dokumentacionin që lidhet me rregjistrimin e shoqërisë "Media 66" të cilat ndodhen në Zyrën e Regjistrimit Tregtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Procesverbali, mbahet në kuadër të procedimit 4372 të vitit 2006 dhe në prani të Sekretares së Regjistrimit tregtar Besa Xorbeci

Dhe konkretisht:

1-Kërkesë e shoqërisë Media 66 drejtuar Gjykatës Rrethit Tirane dy fletë e firmosur nga Aleksandër Frangaj.


2- Vertetim i dates 14.07.2005 i noterës Mimoza Sadushaj Nr 4422 Rep. një fletë

3- Vertetim i dates 14.07.2005 i noterës Mimoza Sadushaj Nr. 92 Rep. një fletë.

4- Akt themelimi i shoqërisë me përgjegjësi

- te kushtuar "MEDIA 66" SH.P.K. date 14.07.2005
tre fletë e firmosur nga Aleksander Frangaj.
- 5- Vërtetim i datës 14.07.2005 i noteres Mimoza Sadushaj Nr. 4420 Rep. Nr. 1223 kol. një fletë.
- 6- Statuti i "MEDIA 66" SH.P.K. dt. 14.07.2005 tetë fletë i firmosur nga Aleksander Frangaj.
- 7- Vërtetim i noteres Mimoza Sadushaj datë 14.07.2005, Nr. 4421 Rep. Nr. 1224 Kol. një fletë.
- 8- Vendim Per Regjistrimin e Personit Juridik Nr. 33812, date 15.07.2005 tre flete e firmosur nga Gjyqtare Ariona Caco.
- 9- Kërkesë e shoperisë Media 66 drejtuar Gjykatës Rrethit Tirane, Seksionit Tregtar, një flete e firmosur nga Aleksander Frangaj.
- 10- Vërtetim i datës 08.02.2006 i noteres Luena Tolica Nr. 91. Rep., Nr. 28 Kol. një fletë.
- 11- Vendim i Ortakut të Vetëm të Shoperisë "MEDIA 66" SH.P.K. një fletë, e firmosur nga ortakun i vetëm Aleksander Frangaj.
- 12- Vërtetim i datës 08. shkurt 2006 i noteres Luena Tolica, Nr. 92. Rep., Nr. 29. Kol. një fletë.
- 13- Vendim Nr. 33812/1 i Gjyqtarës Blerina Musaj një fletë datë 22.02.2006.
- 14- Kërkesë e shoperisë Media 66 drejtuar Gjykatës Rrethit Tirane, Seksionit tregtar një fletë.



 2

15- Vërtetimi i datës 08.05.2006 i noteres Meri Çala, Nr. Rep. 744, Nr. Kol. 214. një fletë
16- Vendim i Ortakut të vetëm të shoqërisë "Media 66" date 05.05.2006 një fletë e firmosur nga Aleksandër Frangaj. një fletë, dy faqe me fapen e dytë vërtetimi i datës 08.05.2006 i noteres Meri Çala Nr.

17- deje Higjieno - Sanitare date 05.06.2006 Nr. 2798 Prot., Nr. 6176 mandati, e Inspektoriatit Sanitar shtetëror, një fletë.

18- Vendim Nr. 33812/2, datë 05.06.2006 i gjyqtarës Enkela Bajë, një fletë.


Mbyllet me numër rendor 18 (tetëmbëdhjetë) Dokumentat e përshkruar me sipër u morën fotokopje të njësuara me origjinalin dhe u vulosën me rulën e Gjykatës së Prethit Gjyqësor Tiranë.

Procesverbali, pasi lexohet gëndet i rregullt dhe firmoset pa rërejtje.

EPRANISHME

Sh. Rrez. Treg.

Besa Kallëci



OF. POL. GJYQËSORE

Ervin Brokaj

